



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria*  
*Vlada-Government*  
*Ministria e Zhvillimit Ekonomik*  
*Ministarstvo Ekonomskog Razvoja-Ministry of Economic Development*

**Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme /Department za Finansije i Opšte Usluge /Department of Finance and General Services**

---

Ministria e Zhvillimit Ekonomik duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës L. Nr. 03/L-149 dhe Rregulloren nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës bënë:

**SHPALLJEN E REKRUTIMIT**

**Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë**

**Numri i Konkursit: APF0005636**

**Vendi i punës: Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Projekte - EZHE/430**

**Koeficienti : 8.00**

**Kohëzgjatja e Emërimit: Pa afat të caktuar**

**Mbikëqyrësi: Udhëheqësit te Sektorit për Promovimin dhe Zhvillimin e Projekteve**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Bashkëpunon me akterët relevantë në funksion të promovimit të eficiencës së energjisë;
- Siguron zbatimin e programeve të fushatave promovuese për eficiencën e energjisë;
- Bashkëpunon me institucionet qendrore dhe lokale dhe me entitete tjera të interesuara për zhvillimin e fushatave promovuese për eficiencën e energjisë;
- Mirëmban ueb faqen e Agjencisë.
- Siguron zbatimin e projekteve te Eficiencës se Energjisë
- Monitoron hartimin dhe dizajnin e projekteve te eficiencës e energjisë
- Monitoron specifikacionin teknik te produkteve te eficiencës se energjisë
- Zyrtari i Lartë për Planifikim dhe Projekte raporton tek udhëheqësi i sektorit për planifikim dhe projekte AKEE-se.
- Kryen detyra tjera që caktohen nga udhëheqësi i sektorit - AKEE-se

### **Kualifikimi i nevojshëm :**

- Diplome Universitare ne fushën e Inxhinierisë Mekanike, Elektrike, Ndërtimtari dhe Ekonomi.
- Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e energjisë ose ekonomisë;
- Shkathtësi të lartë në pune profesionale, caktim të objektivave dhe planifikim;
- Njohuri të mira të punës profesionale të kryer nga vartësit;
- Shkathtësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negocimit;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internet)
- E preferuar njohja e gjuhës angleze;

**Numri i Konkursit: APF0005637**

**Vendi i punës: Zyrtar i Lartë për Zhvillim dhe Monitorim të Zbatimit të Projekteve**

**Koeficienti : 8.00**

**Kohëzgjatja e Emërimit: Pa afat të caktuar**

**Mbikëqyrësi: Udhëheqësi i sektorit për Monitorim dhe Raportim**

### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Mbledhë, përpunon dhe mirëmban te dhënat për konsumin e energjisë ne sektorët konsumit fundor te energjisë;
- Bashkëpunon me institucionet qendrore, lokale dhe etnitetet te tjera përkatëse lidhur me te dhënat e energjisë funksion te bazës se dhënave për eficiencën e energjisë ;
- Mbështet punën e divizioneve tjera te Agjencisë lidhur me te dhënat e energjisë;
- Administron softuerët te AKEE-se, MVP, ENMASOFT dhe ISBM
- Monitorues dhe vlerësues i raportit te Auditimit te Energjisë
- Monitoron planet e veprimtimit komonale për eficiencës se energjisë
- Monitoron projektet te eficiencës se energjisë ne nivel nacional
- Po ashtu nëse kërkohet mirëmban regjistrat lidhur me auditorët dhe menaxheret e energjisë;
- Kryen detyra tjera siç caktohen nga Udhëheqësi i Sektorit

### **Kualifikimi i nevojshëm :**

- Diplome Universitare ne fushën e Inxhinierisë Elektrike, Ndërtimtari, Ekonomi ose Juridik
- Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë në fushën profesionale;
- Njohuri të mira për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit;
- Shkathtësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negocimit;
- Fleksibilitet ndaj organizimit dhe mbikëqyrjes së punës, përfshirë zgjidhjen e problemeve;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internet)

**Numri i Konkursit: APF0005638**

**Vendi i punës: Zyrtar i bazës së të dhënave 1- EZHE/380**

**Koeficienti : 7.00**

**Kohëzgjatja e Emërimit: Pa afat të caktuar**

**Mbikëqyrësi: Udhëheqësi i sektorit për Monitorim dhe Raportim**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Mbledhë, përpunon dhe mirëmban te dhënat për konsumin e energjisë ne sektorët konsumit fundor te energjisë;
- Bashkëpunon me institucionet qendrore, lokale dhe etnitetet te tjera përkatëse lidhur me te dhënat e energjisë funksion te bazës se dhënave për efqiçencen e energjisë ;
- Mbështet punën e divizioneve tjera te Agjencisë lidhur me te dhënat e energjisë;
- Administron softvret te AKEE-se, MVP, ENMASOFT dhe ISBM
- Monitorues dhe vlerësues i raportit te Auditimit te Energjisë
- Monitoron planet e veprimit komunale për efqiçencës se energjisë
- Po ashtu nëse kërkohet mirëmban regjistrat lidhur me auditorët dhe menaxheret e energjisë;
- Kryen detyra tjera siç caktohen nga Udhëheqësi i Sektorit

**Kualifikimi i nevojshëm :**

- Diplome Universitare ne fushën e Inxhinierisë, Elektrike, Ndërtimtarisë, Arkitekturë dhe Ekonomi
- Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e Energjisë ose Ekonomisë;
- Shkathtësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negocimit;
- Fleksibilitet ndaj punës profesionalë, përfshirë zgjidhjen e problemeve;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internet)
- E preferuar njohuri ne gjuhen angleze

**Procedura e konkurrimit**

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatë të jashtëm si dhe nëpunës civil ekzistues te cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në receptionin e ndërtesës së Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (Sheshi Nëna Terezë, Toskanë, Prishtinë) Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjeni edhe në Web faqen <http://mzhe-ks.net>.

Aplikacionit duhet ti bashkëngjiten dokumentet përcjellëse si vijon: Formulari i plotësuar i aplikimit, dëshminë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i), dëshminë e përvojës se punës, dy referenca.

Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm. Kërkesat dorëzohen në Zyrën e Arkivës, kati I-rë, ndërtesa e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik ose me postë.

### **Informatë e përgjithshme për të gjithë kandidatët**

Ministria e Zhvillimit Ekonomik , ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional ne organet e shërbimit civil siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Për shkak te numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatet e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatet e përzgjedhur në listën e ngushtë do ti nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.

Kohëzgjatja e emërimit sipas LSHC, duke përfshirë periudhën e punës provuese një (1) vjeçare.

**Afati i konkurrimit është prej datës 10 /07/2019 deri me date 24/07/ 2019, deri në orën 16:00.**

**Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor.**

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen. Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrat: 038 200 21524